

Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistike në Shqipëri, 2023


Tiranë, Nëntor 5, 2025: INSTAT publikon të dhënat e rishikuara të Prodhimit të Brendshëm Bruto sipas rajoneve statistikore, për periudhën 2000-2023. Rishikimi i serisë së të dhënave të PBB-së, paraqet përmirësime në metodologji dhe afate kohore.

Në vitin 2023, sipas rajoneve statistikore në nivel 1 (Republika e Shqipërisë), PBB me çmime korrente u vlerësua 2.364.276 milionë Lekë, duke shënuar një rritje në terma realë prej rreth 4,02 %, krahasuar me vitin 2022.

Kontributin më të madh në rritjen ekonomike për vitin 2023, e ka dhënë Qarku Tiranë me +2,06 pikë përqindje, pasuar nga Qarku Fier me një kontribut prej +0,43 pikë përqindje dhe Qarku Durrës me +0,42 pikë përqindje.

Kontributin më të ulët në rritjen ekonomike e ka dhënë Qarku Kukës me +0,04% pikë përqindje, i pasuar nga Qarku Dibër me një kontribut prej +0,06 pikë përqindje dhe Qarku Gjirokastrë me një kontribut +0,07 pikë përqindje.

Fig.1 Kontributi i Qarqeve në rritjen ekonomike, viti 2023*



*2023 Të dhëna finale

Në vitin 2023, sipas rajoneve statistikore në nivel 2, PBB me çmime korrente në rajonin Veri ishte 531,8 miliardë Lekë ose 22,49 % ndaj totalit të vendit. Krahasuar me vitin 2022 në rajonin Veri, PBB në terma reale shënoi një rritje me 3,05 %.

PBB me çmime korrente në rajonin Qendër, ishte 1.080,6 miliardë Lekë ose 50,26 % ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2022, për rajonin Qendër, PBB në terma reale shënoi një rritje prej 4,45 %. PBB me çmime korrente në rajonin Jug ishte 644,2 miliardë Lekë ose 27,25 % ndaj totalit të vendit. Krahasuar me vitin 2022 në rajonin Jug, PBB në terma reale shënoi një rritje prej 4,02 %.

Sipas rajoneve statistikore në nivel 3 (Qark), rritjen reale më të lartë të PBB-së e shënoi Qarku Vlorë me një rritje në terma reale prej 5,22 %, i ndjekur nga Qarku Tiranë me një rritje në terma reale prej 4,71 % dhe Qarku Fier me një rritje në terma reale prej 4,13 % të PBB-së për vitin 2023, krahasuar me vitin 2022.

Rritjen reale më të ulët të PBB-së e shënoi Qarku Shkodër, duke shënuar një rritje në terma reale prej 1,32%, më pas renditet Qarku Dibër me një rritje në terma reale prej 2,13% dhe Qarku Berat me një rritje në terma reale prej 2,69 % të PBB-së për vitin 2023, krahasuar me vitin 2022.

Tab. 1 PBB sipas rajoneve statistikore


Kodi	Niveli Statistikor 2/3	PBB çmime korrente (milion Lekë) 2022	PBB çmime korrente (milion Lekë) 2023*	Rritja Reale e PBB-së 2023/2022	Kontributi ndaj rritjes Reale 2023/2022	Struktura ndaj PBB-së 2022	Struktura ndaj PBB-së 2023
AL	Republika e Shqipërisë	2.149.744	2.364.276	4,02	4,02	100,0	100,0
AL01	Veri	486.431	531.802	3,05	0,69	22,63	22,49
AL011	Dibër	58.246	64.640	2,13	0,06	2,71	2,73
AL012	Durrës	222.854	244.024	4,02	0,42	10,37	10,32
AL013	Kukës	30.909	33.940	2,76	0,04	1,44	1,44
AL014	Lezhë	63.600	70.072	3,67	0,11	2,96	2,96
AL015	Shkodër	110.822	119.125	1,32	0,07	5,16	5,04
AL02	Qendër	1.080.685	1.188.180	4,45	2,23	50,27	50,26
AL021	Elbasan	139.427	151.261	2,65	0,17	6,49	6,40
AL022	Tiranë	941.258	1.036.919	4,71	2,06	43,78	43,86
AL03	Jug	582.628	644.294	4,02	1,09	27,10	27,25
AL031	Berat	77.516	84.846	2,69	0,10	3,61	3,59
AL032	Fier	226.368	249.902	4,13	0,43	10,53	10,57
AL033	Gjirokastrë	46.767	51.276	3,31	0,07	2,18	2,17
AL034	Korçë	103.994	114.783	3,61	0,17	4,84	4,85
AL035	Vlorë	127.983	143.487	5,22	0,31	5,95	6,07

* 2023 Të dhëna finale

PBB për frymë sipas niveleve statistikore

Në vitin 2023, niveli i PBB-së për frymë në rajonin statistikor nivel 1 (Republika e Shqipërisë), sipas rezultateve të Census 2023 rezulton 984 mijë Lekë.

Fig.2 PBB për frymë sipas rajoneve statistikore nivel 3, viti 2023* (000/Lekë)



*2023 Të dhëna finale

Në vitin 2023, sipas rajoneve statistikore në nivel 2, në rajonin statistikor Veri, PBB për frymë është 819 mijë Lekë. PBB për frymë e këtij rajoni është 16,80 % nën mesataren e vendit. Në rajonin statistikor Qendër, PBB për frymë është 1.199 mijë Lekë. PBB për frymë e këtij rajoni rezultoi 21,86 % mbi mesataren e vendit. Në rajonin statistikor Jug, PBB për frymë është 845 mijë Lekë. PBB për frymë e këtij rajoni është 14,12 % nën mesataren e vendit.

Në vitin 2023, niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3 (Qark), në vitin 2023, u regjistrua në Qarkun Tiranë, me 1.367 mijë Lekë, duke u vlerësuar 38,90 % mbi mesataren e vendit. Pas tij renditet Qarku Durrës me PBB për frymë 1.086 mijë Lekë, duke u vlerësuar 10,31 % mbi mesataren e vendit dhe Qarku Fier me 1.042 mijë Lekë, 5,82 % mbi mesataren e vendit.

Niveli më i ulët i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3 (Qark) në vitin 2023, u vlerësua në Qarkun Kukës me rreth 549 mijë Lekë dhe PBB për frymë e këtij qarku vlerësohet 44,19 % nën mesataren e vendit. Më tej, me PBB-në për frymë më të ulët vijon Qarku Dibër me rreth 595 mijë Lekë dhe PBB për frymë e këtij qarku vlerësohet 39,53% nën mesataren e vendit dhe qarku Berat me 599 mije Lekë. PBB për frymë e këtij qarku vlerësohet 39,18 % nën mesataren e vendit.

Tab. 2 PBB për frymë sipas rajoneve statistikore, 2023*

Kodi	Niveli Statistikor 2/3	PBB për frymë (mijë Lekë)	Indeksi ndaj PBB-së (%)
		2023	AL=100 2023
AL	Republika e Shqipërisë	984	100,00
AL01	Veri	819	83,20
AL011	Dibër	595	60,47
AL012	Durrës	1.086	110,31
AL013	Kukës	549	55,81
AL014	Lezhë	694	70,46
AL015	Shkodër	771	78,35
AL02	Qendër	1.199	121,86
AL021	Elbasan	652	66,28
AL022	Tiranë	1.367	138,90
AL03	Jug	845	85,88
AL031	Berat	599	60,82
AL032	Fier	1.042	105,82
AL033	Gjirokastrë	854	86,81
AL034	Korçë	662	67,31
AL035	Vlorë	973	98,81

*2023 Të dhëna finale

Tab. 4 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore (Dega = 100 %), viti 2023*

Kodi	Nivelet Statistikore 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm, Publike; Arsimi; Shëndetësia	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime korente
AL	Republika e Shqipërisë	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
AL01	Veri	27,8	30,4	19,2	22,5	7,4	25,3	25,0	16,3	17,2	14,3	22,49
AL011	Dibër	5,9	5,1	1,9	0,9	0,4	3,2	1,4	0,9	2,3	0,5	2,7
AL012	Durrës	6,8	14,9	9,5	14,0	3,5	10,1	14,7	9,8	5,8	9,4	10,3
AL013	Kukës	2,9	1,5	0,6	0,9	0,4	1,9	1,0	0,4	2,1	0,5	1,4
AL014	Lezhë	4,7	2,8	2,7	2,9	0,5	4,8	2,9	1,6	2,5	1,0	3,0
AL015	Shkodër	7,6	6,2	4,4	3,9	2,7	5,2	5,1	3,6	4,5	3,0	5,0
AL02	Qendër	16,3	43,3	59,9	55,2	85,7	43,6	51,3	73,8	63,0	70,7	50,3
AL021	Elbasan	11,6	8,1	5,2	5,1	1,5	5,6	5,3	1,5	5,9	2,1	6,4
AL022	Tiranë	4,7	35,3	54,7	50,1	84,2	37,9	45,9	72,3	57,1	68,6	43,9
AL03	Jug	55,9	26,2	20,9	22,3	7,0	31,1	23,8	9,9	19,8	15,0	27,3
AL031	Berat	8,9	2,8	1,8	2,9	1,4	5,3	2,4	0,8	2,6	1,3	3,6
AL032	Fier	25,3	13,1	6,8	6,9	2,0	8,4	8,0	3,0	5,5	4,8	10,6
AL033	Gjrokaštër	3,2	1,7	2,0	2,4	0,4	3,0	1,4	1,1	2,5	0,9	2,2
AL034	Korçë	10,4	4,3	2,5	4,2	1,2	6,1	4,3	1,4	4,3	3,9	4,9
AL035	Vlorë	8,1	4,3	7,8	6,0	1,9	8,3	7,7	3,6	4,9	4,1	6,1

*2023 Të dhëna finale

Tab. 5 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas rajoneve statistikore dhe degëve të ekonomisë (Rajoni = 100 %), viti 2023*

Kodi	Nivelet Statistikore 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime korente
AL	Republika e Shqipërisë	18,7	13,2	13,4	21,2	2,8	1,9	5,7	8,1	13,0	2,1	100,0
AL01	Veri	23,1	17,9	11,4	21,2	0,9	2,1	6,3	5,9	9,9	1,3	100,0
AL011	Dibër	40,1	24,6	9,2	6,8	0,4	2,2	2,8	2,6	10,8	0,4	100,0
AL012	Durrës	12,2	19,0	12,3	28,7	0,9	1,8	8,1	7,7	7,3	1,9	100,0
AL013	Kukës	37,9	14,0	6,0	13,5	0,7	2,5	3,8	2,1	18,7	0,7	100,0
AL014	Lezhë	29,5	12,5	12,4	20,4	0,5	3,0	5,6	4,4	11,0	0,7	100,0
AL015	Shkodër	28,0	16,2	11,6	16,3	1,5	2,0	5,7	5,9	11,7	1,2	100,0
AL02	Qendër	6,1	11,4	15,9	23,3	4,8	1,6	5,8	11,9	16,3	2,9	100,0
AL021	Elbasan	33,8	16,6	10,9	16,9	0,6	1,7	4,7	2,0	12,0	0,7	100,0
AL022	Tiranë	2,0	10,6	16,7	24,2	5,4	1,6	5,9	13,4	16,9	3,3	100,0
AL03	Jug	38,3	12,7	10,3	17,3	0,7	2,1	4,9	2,9	9,5	1,1	100,0
AL031	Berat	46,4	10,3	6,8	16,9	1,1	2,8	3,8	1,8	9,4	0,8	100,0
AL032	Fier	44,8	16,4	8,6	13,8	0,5	1,5	4,3	2,3	6,8	0,9	100,0
AL033	Gjirokastrë	27,2	10,7	12,4	23,1	0,6	2,6	3,6	3,9	15,2	0,9	100,0
AL034	Korçë	39,9	11,6	6,8	18,1	0,7	2,4	5,1	2,4	11,4	1,7	100,0
AL035	Vlorë	25,1	9,3	17,2	20,9	0,9	2,6	7,2	4,9	10,6	1,4	100,0

*2023 Të dhëna finale

Metodologjia

Ky publikim paraqet rezultatet e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2023 në Republikën e Shqipërisë sipas rajoneve statistikore në nivel 1, 2 dhe 3, të përcaktuara sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian, si dhe degëve të ekonomisë sipas nomenklaturës NVE Rev 2.

Llogaritë Kombëtare Rajonale bazohen në metodologjinë ESA 2010, kryesisht te Kapitulli 13, duke marrë si bazë vlerësimet më të fundit të Llogarive Kombëtare Vjetore të publikuara më 26 Qershor 2025, në mënyrë që të ruhet konsistenca e këtyre treguesve.

Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e treguesve rajonalë mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993. Sistemi evropian i llogarive kombëtare dhe rajonale është korniza për matjen e aktiviteteve ekonomike dhe financiare të një sistemi ekonomik, komponentëve të tij dhe lidhjeve midis tyre në një periudhë kohe të dhënë (zakonisht një vit). Transaksionet e kryera nga agjentët ekonomikë në lidhjet e tyre me njësitë e tjera rezidente ose jo rezidente në territorin ekonomik janë objekt i matjeve në llogaritë kombëtare rajonale. Përditësimet e klasifikimeve bëhen që treguesit ekonomikë rajonalë të jenë më të dobishëm për përdoruesit, në mënyrë që të pasqyrojnë zhvillimet ekonomike dhe të përmirësojnë krahasueshmërinë e të dhënave midis rajoneve dhe vendeve anëtare të BE-së bazuar në Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian.

Parimi i Rezidencës

Parimi kryesor për alokimin e VSHB-së në Llogaritë Rajonale është se Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) duhet të alokohet në rajonin ku njësia prodhuese është rezidente, pra që do të thotë se VSHB shpërndahet në rajonin ku krijohet.

Ndryshimet në vlerësimet e Llogarive Kombëtare Vjetore kanë reflektuar dhe në Llogaritë Rajonale si në të dhëna dhe në metodologji. INSTAT ka bërë një ndryshim cilësor në zhvillimin e metodave në vlerësimin e VSHB-së rajonale për ndarjen e veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve dhe institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë kryesore në një apo më shumë rajone. Në lidhje me metodologjinë e përdorur konsultohuni me materialin: “Metodologjia e Llogarive Rajonale në Shqipëri” në adresën e mëposhtme:

<https://www.instat.gov.al/media/4638/part-e-regional-accounts-albania.pdf>

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare Rajonale janë:

- Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike REV.2 (NVE Rev.2).
- Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS).

Nomenklatura e njësive territoriale për statistikat (NUTS) është një klasifikim i përbashkët, në bazë të të cilit mbliidhen dhe përpunohen, statistikat rajonale evropiane.